



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 137/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi Kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, paraqitur kundër Fexhrije Konushevcit kandidatë për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Nisma për Kosovën, dega në Besianë, për shkak të vendosjes të banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ndërsa Nisma për Kosovën, dega në Besianë i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Besianë, në të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 11:53 kanë vërejtur se mbi rrugën “Zahir Pajaziti” në Besianë ishte vendosur baneri i kandidatës për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës Fexhrije Konushevcit me numër 39 nga radhët e Nisma për Kosovën. Andaj me këtë veprim është bërë shkelje e nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, pretendohet në ankesën e LVV-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një fotografi dhe emrin e një dëshmitarit.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, PZAP-i me datë 05.06.2014 e informoi Nisma për Kosovën për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në Kërkesë Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga Nisma për Kosovën me të cilën theksohet se pasi që është njoftuar për ankesën që është ushtruar nga LVV, ka larguar menjëherë banerin e kandidatës Fexhrije Konushevcit dhe si provë kanë bashkangjitur fotografit në të cilën shihet që nuk ekziston baneri në atë vend.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se Nisma për Kosovën ka vendosur banerin mbi rrugën publike “Zahir Pajaziti” në Besianë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh se Nisma për Kosovën pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese nga PZAP-i, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se Nisma për Kosovën ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parashihet se *”Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore“* dhe duke u bazuar në shkallën dhe peshën e shkeljes për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, se Nisma për Kosovën merr pjesë për herë të parë në Zgjedhje si subjekt politik dhe duke pasur parasysh se nga ana e Nisma për Kosovën është larguar baneri në fjalë, menjëherë pas marrjes së Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për Ndërmarr Masat Përmirësuese nga PZAP-i, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në Kërkesës Përgjigje dhe Urdhër për të Ndërmarr Masa Përmirësuese e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 137/2014 më datën 06.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi

Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij, do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*

